



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 293/22 Prot.

Tiranë, më 01 . 03 .2021

UDHËZIM

Nr. 1, Datë 01 . 03 .2021

PËR

**PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
SPECIALIZIMEVE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E
MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021**

Në mbështetje të neneve 18, 70, 71, 77, 78 dhe 89 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", Vendimit nr. 37 prot., datë 28.04.2020 "*Mbi zhvillimin e proceseve akademike në situatën e krijuar nga infeksioni COVID-19 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë*", të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores të studimeve të specializimeve afatgjata të ciklit të tretë..., Vendimit nr. 23, datë 26.02.2021 "*Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2020-2021, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë*", si dhe VKM-së nr.1013, datë 10.12.2010 "*Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)*", i ndryshuar me VKM nr. 371, datë 26.04.2017, sot Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA),

UDHËZOJ:

1. Kandidatët aplikojnë për një program specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë (UMT), në vitin akademik 2020-2021, respektivisht, në zbatim Vendimit nr. 23, datë 26.02.2021 "*Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2020-2021, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë*" të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, nga data **08.03.2021 deri më datë 23.03.2021**.

Procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe konkurrimit bëhen konform rregullores së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë të miratuar, nga Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë me Vendimin Nr. 88, datë 16.11.2016, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 37 prot., datë 28.04.2020 të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

2. Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, të organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë. Procesi monitorohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e specializimeve afatgjata, në fushën e mjekësisë, kandidatët që:

- a. Kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse, në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", si dhe kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë;
- b. Janë diplomuar jashtë vendit në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MASR, si dhe kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë.

4. Për të aplikuar në programet e specializimit afatgjatë për të cilat janë parashikuar kuota sipas tabelës, bashkëlidhur Vendimit nr. 23, datë 26.02.2021 të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, kandidatët duhet të kenë përfunduar një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në fushën e mjekësisë.

Të gjithë kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.

5. Kandidati paraqitet personalisht për të bërë aplikimin dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Formular aplikimi, sipas modelit të parashikuar në Shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi (kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh plotësojnë formularin sipas modelit të parashikuar në shtojcën nr.1a);
- b. Letër motivimi i/e aplikantit;
- c. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë;
- d. Kopje e njëzuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare, të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" si dhe të ciklit të dytë "Master i Shkencave" ose të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë, dhe listës / listave të notave. Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njëzuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën /diplomat dhe listën/listat përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë përkatës. Në rast se njohja e diplomës nuk ka përfunduar ende, kandidati paraqet vërtetim që ka dorëzuar dokumentacionin për njohje në MASR, dhe duhet të dorëzojë dokumentin e njohjes jo më vonë se data e parashikuar për testimin e informatizuar, si dhe përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar nga Komisioni i Vlerësimit;
- e. Kopje e njëzuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit që vërteton njohjen e gjuhës së huaj, sipas përcaktimit në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë përkatësisht *"Të zotërojnë të paktën një nga gjuhët e huaja (anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht) në nivelin B2, si kriter minimal në programet e studimit të ciklit të tretë të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, me kusht që afati i fundit për paraqitjen e shlyerjes së gjuhës së huaj në nivel C1, sipas akteve nënligjore në fuqi, për këtë kategori studentësh të jetë përpara përfundimit të vitit të parë akademik"* të programit përkatës.
- f. Fotokopje e noterizuar e licencës së ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë dhe e dëshmisë së regjistrimit në Urdhrin profesional përkatës;
- g. Dëshmi penaliteti e vlefshme;
- h. Mandat pagesa për tarifën e konkurrit (intervistën me gojë) prej 5,000 (pesëmijë)lekë;
- i. Kandidatët që aplikojnë për kuotat e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Ministrisë së Brendshme, dorëzojnë një letër mbështetëse të ministrisë përkatëse sipas formatit të parashikuar në Shtojcën nr.2, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- j. Dy foto personale.

6. Dekanatet brenda datës **29.03.2021** shpallin në faqen zyrtare Web të fakulteteve dhe/ose UMT- së listën emërore të kandidatëve të regjistruar për konkurrim, të cilët plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit. Kandidatët verifikojnë listën emërore të shpallur dhe në rast pasaktësish, bëjnë kërkesë për saktësim pranë dekanatit të fakultetit përkatës brenda datës **02.04.2021**.

Dekanatet pas kryerjes së verifikimeve shpallin brenda datës **03.04.2021** listën përfundimtare të kandidatëve, si dhe kalendarin e zhvillimit të testimit të informatizuar. Datat e zhvillimit të testimit të informatizuar konsultohen me QSHA lidhur me disponibilitetin për zhvillimin e testimit të informatizuar. Listat përfundimtare i dërgohen QSHA dhe MASR brenda kësaj datë sipas formatit të kërkuar nga QSHA.

7. Testimi i informatizuar fillon jo më parë se 30 ditë nga publikimi i fondit të pyetjeve. Testimi i informatizuar zhvillohet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) sipas kalendarit të përcaktuar nga Dekanatet, bazuar në disponibilitetin e ambienteve të testimit të përcaktuara nga QSHA.
8. Ditën e zhvillimit të provimit, kandidatët duhet të kenë dokumentacionin e mëposhtëm:
- a. Dokument identiteti (kartë identiteti ose pasaportë), si dhe një fotokopje të saj;
 - b. Mandat pagesën për tarifën e testimit të informatizuar për llogari të QSHA-së, sipas VKM nr. 560, datë 29.09.2018, pika 2, aneksi 1/3 (mandat pagesa tërhiqet pranë QSHA)

si dhe të zbatojnë rregullat si më poshtë:

- i. të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të provimit/testimit;
- ii. ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter skualifikimi;
- iii. ndalohet duhani dhe konsumimi ushqimit në mjediset e provimit;
- iv. ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit.

Sallat e provimit mbikëqyren nga një ose më shumë administratorë, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit /testimit sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve dhe këtij udhëzimi.

9. Qendra e Shërbimeve Arsimore si autoritet në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kryen dhe zbaton procedurat për zhvillimin e provimeve të specializimit, përmes teknologjisë digjitale. QSHA lidhur me zhvillimin e provimeve të specializimit, kryen sa më poshtë:
- a. Digjitalizon fondin e pyetjeve për çdo specialitet të miratuar nga Komisioni i Vlerësimit.
 - b. Harton në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë dhe Fakultetin e Mjekësisë Dentare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, grafikun e datave të provimeve.
 - c. Publikon listat e kandidatëve sipas datës dhe orarit të caktuar për zhvillimin e provimit.
 - d. Verifikon identitetin dhe dokumentet përkatëse të kandidatëve pjesëmarrës në provimet e specializimit.
 - e. Siguron kushte të përshtatshme në sallat e provimit për zhvillimin e provimit të specializimit përmes teknologjisë digjitale.
 - f. Siguron kushte të përshtatshme për kandidatët me aftësi të kufizuara fizike.
 - g. Merr masa për hartimin e formatit të testit sipas përcaktimit të bërë nga Komisioni i Vlerësimit.
 - h. Mban procesverbale për çdo vendimmarrje gjatë procedurave të zhvillimit të provimeve të specializimit, deri në shpalljen e rezultateve.
 - i. Dërgon rezultatet e provimit të specializimit pranë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
10. Në përfundim të testimit të të gjithë kandidatëve, Komisioni i Vlerësimit përgatit listën përmblledhëse të meritës me rezultatet kumulative të testimit të informatizuar dhe notës mesatare,

duke renditur kandidatët sipas pikëve në rend zbritës, sipas tabelës së paraqitur në Shtojcën nr. 3 dhe 4 bashkëlidhur. Tabela më sipër miratohet nga Komisioni i Vlerësimit, shpallet dhe afishohet në vende të dukshme, brenda 2 ditëve nga përfundimi i testimit të informatizuar, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe ne faqet ueb të fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare të UMT-së.

Vlerësimi me pikë i kandidatëve bëhet konform rregullores përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, si dhe Vendimit nr. 37 prot., datë 28.04.2020 të Senatit Akademik të UMT-së *"Mbi zhvillimin e proceseve akademike në situatën e krijuar nga infeksioni COVID-19 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë"*, sipas pikës II/1, ku përcaktohet se: *Vlerësimi i kandidatëve ... të bëhet me sistem pikësh maksimumi 1000 pikë të konvertuara, nga ku 30 % e pikëve (300 pikë të konvertuara, të rrumbullakosura me dy shifra pas presjes dhjetore) do të vijnë nga nota mesatare e ponderuar dhe 70% (700 pikë të konvertuara, të rrumbullakosura me dy shifra mbas presjes dhjetore) do të vijnë nga testimi i informatizuar sipas përcaktimeve në nenin 38 të Rregullores së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.*

Kandidatët mund të ankimojnë rezultatin brenda 2 ditëve nga shpallja e listës paraprake. Komisioni i vlerësimit merr në shqyrtim ankimimet dhe prononcohet brenda 3 ditëve me vendimin përkatës.

Pas këtij procesi, Komisioni i Vlerësimit shpall listën e kandidatëve të kualifikuar, duke i renditur sipas pikëve kumulative në rend zbritës. Kandidatët që kanë grumbulluar jo më pak se 380 pikë nga numri i pikëve totale të konvertuara, kualifikohen për procesin e përzgjedhjes së programit të specializimit sipas sistemit të meritës.

11. Zgjedhja e programit të specializimit afatgjatë bëhet brenda 2 ditëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare, përfshirë dhe procedurat e ankimimit sipas afateve të përcaktuara në rregulloren e specializimeve. Të drejtën e regjistrimit si fitues e kanë aq persona sa janë edhe kuotat e caktuara në programin e Specializimit përkatës, sipas rendit zbritës të pikëve totale.
12. Zgjedhja e specializimit bëhet në mënyrë transparente, nga vetë kandidatët fitues, sipas rendit zbritës të pikëve në listën përfundimtare, të ndërtuar në bazë të pikëve të fituara nga çdo kandidat, si dhe në përputhje me kuotat e Vendimit të Senatit Akademik përkatës, në prani të Komisionit të Vlerësimit, të drejtuar nga Dekanët, ose përfaqësuesi i tij, me praninë e të interesuarve (në grupe me nga 5 konkurrues).
13. Regjistrimi i kandidatëve në programet e specializimit afatgjatë ku janë shpallur fitues bëhet brenda 7 ditëve nga data e përzgjedhjes së specializimit.
14. Transferimet e studimeve do të kryhen në zbatim të pikës 3 dhe 4 të Vendimit nr. 23, datë 26.02.2021 të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
Kandidati, në momentin e aplikimit, veç sa është parashikuar në pikën 5 të këtij udhëzimi, dorëzon dhe kopje të noterizuar të dokumentacionit si më poshtë:
 - a. Planin e plotë të programit të studimit specializues të ndjekur;
 - b. Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, si dhe syllabuset përkatëse për lëndët e shlyera, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur dhe/ ose vërtetim vlerësimi për periudhat e praktikave dhe frekuentimin e aktiviteteve të parashikuara në programin e specializimit të ndjekur.

Aplikimet për transferimin e studimeve shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit në të njëjtat data me aplikantët e tjerë të përcaktuara në këtë udhëzim.

15. Kandidati transferohet në vit të parë ose të dytë, por jo më lart se viti i dytë i studimeve. Kandidatët që plotësojnë kriteret për tu transferuar, vlerësohen për periudhën e specializimit të

kryer dhe ekuivalentimin e saj, si dhe krediteve të përfituara gjatë studimeve të mëparshme duke i përcaktuar vitin se ku mund të transferohet eventualisht kandidati.

Për kandidatët që kërkojnë të transferohen nga programe specializimi, sipas pikës 4 të Vendimit nr. 23, datë 26.02.2021 të Senatit Akademik, duhet të merret miratimi paraprak për transferim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me të cilën është lidhur kontrata e mëparshme. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shprehet, gjithashtu, për rastet kur kandidatët kërkojnë të transferohen nga një program specializimi për të cilin nuk kanë lidhur kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në një program specializimi që parashikon kuotë transferimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

16. Regjistrimi i kandidatëve që transferohen në programet e specializimit afatgjatë ku janë shpallur fitues bëhet brenda 7 ditëve nga data e shpalljes. Kandidatët që do të regjistrohen në kuadër të kuotave të transferimit duhet të dorëzojnë dhe dokumentin e çregjistrimit nga programi i specializimit ku transferohen.
17. Brenda 30 ditëve punë nga regjistrimi i kandidatëve fitues, UMT i dërgon QSHA-së, në rrugë postare, listën e studentëve specializantë të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi në zbatim të Udhëzimit Nr. 6, datë 19.02.2018 *"Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimi"*.
18. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose private. QSHA pas verifikimit i kërkon UMT-së ta çregjistrojë atë.
19. Për specializantët që kanë përfutur nga kuotat e mbuluara, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale apo nga Ministri të tjera, marrëdhëniet kontraktuale financiare lidhen mes specializantit dhe Ministrisë përkatëse sipas parashikimeve në Rregulloren përkatëse.
20. Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen në këtë udhëzim merret për referencë Rregullorja e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, miratuar me Vendim Nr. 88, datë 16.11.2016 *"Për miratimin e rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë"* të Senatit Akademik të UMT-së, e ndryshuar.
21. Ngarkohen njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij Udhëzimi.
22. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe i përcillet Ministrive përkatëse dhe QSHA-së.

REKTORI

Arben GJATA



Shtojca Nr.1

FORMULAR APLIKIMI

Unë i/e nënshkruari/a _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri

në _____, Vendbanimi _____

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

Adresa _____

Tel _____, Cel _____, E-mail _____

KËRKOJ:

Të aplikoj për të vazhduar Specializimin Afatgjatë pranë Fakultetit të _____ duke përfutur nga (të shënohet me "x" vetëm një nga alternativat e mëposhtme):


- ☐ Kuotat e pranimi të mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë /Kuotat e pambuluara (të lira)
- ☐ Kuotat e pranimi për Ministrinë e Drejtësisë
- ☐ Kuotat e pranimi për Ministrinë e Mbrojtjes

Në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë, nën përgjegjësinë time ligjore,

DEKLAROJ se:

- Zotëroj:
 - ☐ Diplomë të Integruar të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në _____, lëshuar nga IAL _____, Shteti _____
 - ☐ të njohur në RSH (për diplomat e huaja)
 - ☐ Diplomë të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në _____, Lëshuar nga IAL _____, Shteti _____
 - ☐ të njohur në RSH (për diplomat e huaja)
- Kam notë mesatare të ponderuar të gjithë viteve të studimeve universitare (cikli i parë+cikli i dytë ose diplomë e integruar e ciklit të dytë) _____ (me dy shifra të rrumbullakosura pas presjes dhjetore).
- Nuk jam duke kryer dhe nuk kam kryer më parë një program specializimi afatgjatë në fushën e mjekësisë.
- Zotëroj gjuhën/t e huaj/a më poshtë:

Angleze,	niveli _____
Italiane,	niveli _____
Frënge,	niveli _____
Gjermane,	niveli _____
Spanjolle,	niveli _____



- Bashkëlidhur këtij formulari kam dorëzuar:
 - ☐ Letër motivimi.
 - ☐ Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë.
 - ☐ Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare, të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” si dhe të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, ose të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë, dhe listës/listave të notave. Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën/diplomat dhe listën/listat përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë përkatës.
 - ☐ Për rastet e diplomave të huaja kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë e shoqëruar me diplomën dhe listën përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet të lëshuar nga Institucioni i arsimit të lartë përkatës.
 - ☐ Vërtetim që ka dorëzuar dokumentacionin për njohje në organin kompetent (nëse procesi i njohjes nuk ka përfunduar ende). Dokumenti i njohjes duhet të dorëzohet jo më vonë se data e parashikuar për testimin e informatizuar, si dhe përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar nga Komisioni i Vlerësimit.
 - ☐ Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit/eve që vërteton/jnë njohjen e gjuhës së huaj/gjuhëve të huaja.
 - ☐ Fotokopje e noterizuar e licencës për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë.
 - ☐ Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së regjistrimit në Urdhrin Profesional përkatës në Republikën e Shqipërisë.
 - ☐ Dëshmi penaliteti e vlefshme.
 - ☐ Letër mbështetëse nga Ministria përkatëse.
 - ☐ Mandat pagesën për aplikimin dhe konkurrimin (e cila është e pakthyeshme)
 - ☐ Dy foto personale.
- Deklaroj se jam në dijeni të faktit se në përfundim të procesit të konkurrimin dhe pas regjistrimit, duhet të paraqes kontratën e nënshkruar me ministrinë përkatëse, jo më vonë se 2 (dy) javë nga data e regjistrimit. Mosrespektimi i kësaj kontrate ka penalitetet përkatës të parashikuara në kontratën e lidhur mes palëve.
- Autorizoj UMT, Ministrinë përgjegjëse për arsimin, Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe QSHA për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve specializuese, si dhe publikimin eventuale të tyre.
- Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe QSHA për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.
- Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik në të cilin po aplikoj.
- Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

- Deklaroj se jam njohur me Rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, si dhe udhëzimin përkatës të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit dhe konkurrimit, si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në rregulloren e sipërcituar, udhëzimin, si dhe vendimin përkatës të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
- Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose QSHA nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve ligjore kompetente.

(_____)

Emër Atësi Mbiemër

i kandidatit

Firma


(_____)

Emër Mbiemër

i punonjësit të ngarkuar për pranimin e aplikimit

Firma

Vendi: _____ Data: ____ . ____ . _____, ora _____



Shtojca nr. 1 a

FORMULAR APLIKIMI (Për transferimet)

Unë i/e nënshkruari/a _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri

në _____, Vendbanimi _____

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

Adresa _____

Tel _____, Cel _____, E-mail _____


KËRKOJ:

Të transferohem për të vazhduar Specializimin Afatgjatë në programin e studimit: _____, ID _____

Në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë, nën përgjegjësinë time ligjore,

DEKLAROJ se:

- Zotëroj:
 - ☐ Diplomë të Integruar të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në _____, lëshuar nga IAL _____, Shteti _____
 - ☐ të njohur në RSH (për diplomat e huaja)
 - ☐ Diplomë të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në _____, lëshuar nga IAL _____, Shteti _____
 - ☐ të njohur në RSH (për diplomat e huaja)
- Kam notë mesatare të ponderuar të të gjithë viteve të studimeve universitare (cikli i parë+cikli i dytë ose diplomë e integruar e ciklit të dytë) _____ (me dy shifra të rrumbullakosura pas presjes dhjetore).
- Po ndjek programin specializues afatgjatë në _____ pranë IAL-së _____, shteti _____
- Zotëroj gjuhën/t e huaj/a më poshtë:
 - ☐ Angleze niveli _____
 - ☐ Italiane niveli _____
 - ☐ Frënge niveli _____
 - ☐ Gjermane niveli _____
 - ☐ Spanjolle niveli _____
- Bashkëlidhur këtij formulari kam dorëzuar:
 - ☐ Letër motivimi.
 - ☐ Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë.
 - ☐ Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare, të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” si dhe të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, ose të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë, dhe listës/listave të notave. Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën



e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën/diplomat dhe listën/listat përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë përkatës.

- ☐ Për rastet e diplomave të huaja kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë e shoqëruar me diplomën dhe listën përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet të lëshuar nga Institucioni i arsimit të lartë përkatës.
 - ☐ Vërtetim që ka dorëzuar dokumentacionin për njohje në ministrinë përgjegjëse për arsimin (nëse procesi i njohjes nuk ka përfunduar ende). Dokumenti i njohjes duhet të dorëzohet jo më vonë se data e parashikuar për testimin e informatizuar, si dhe përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar nga Komisioni i Vlerësimit.
 - ☐ Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit/eve që vërteton/jnë njohjen e gjuhës së huaj/gjuhëve të huaja.
 - ☐ Fotokopje e noterizuar e licencës për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë.
 - ☐ Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së regjistrimit në Urdhrin Profesional përkatës në Republikën e Shqipërisë.
 - ☐ Dëshmi penaliteti e vlefshme.
 - ☐ Letër mbështetëse nga Ministria përkatëse.
 - ☐ Mandat pagesën për konkurrimin (e cila është e pakthyeshme)
 - ☐ Dy foto personale.
 - ☐ Planin e plotë të programit të studimit specializues të ndjekur;
 - ☐ Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, si dhe syllabuset përkatëse për lëndët e shlyera i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;
 - ☐ Vërtetim për periudhat e praktikave dhe frekuentimin e aktiviteteve të parashikuara në programin specializues të ndjekur.
- Deklaroj se jam në dijeni të faktit se në përfundim të procesit të konkurrimin dhe pas regjistrimit, duhet të paraqes kontratën e nënshkruar me ministrinë përkatëse, jo më vonë se 2 (dy) javë nga data e regjistrimit. Mosrespektimi i kësaj kontrate ka penalitetet përkatës të parashikuara në kontratën e lidhur mes palëve.
 - Autorizoj UMT, Ministrinë përgjegjëse për arsimin, Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe QSHA për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve specializuese, si dhe publikimin eventual të tyre.
 - Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe QSHA për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.
 - Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik në të cilin po aplikoj.
 - Deklaroj se jam në dijeni se para regjistrimit përfundimtar duhet të paraqes dokumentin e çregjistrimit nga programi specializues afatgjatë që jam duke ndjekur, dhe se mosparaqitja e dokumentit të çregjistrimit nuk lejon regjistrimin përfundimtar në programin specializues ku kam aplikuar. Deklaroj se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

- Deklaroj se jam njohur me rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, si dhe udhëzimin përkatës të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit dhe konkurrimit, si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në rregulloren e sipërcituar, udhëzimin, si dhe vendimin përkatës të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë
- Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë; Ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose QSHA nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve ligjore kompetente.

(_____)

Emër Atësi Mbiemër
i kandidatit


Firma

(_____)

Emër Mbiemër
i punonjësit të ngarkuar për pranimin e aplikimit

Firma

Vendi: _____ Data: ____ . ____ . _____, ora _____



Shtojca nr. 2

Stema dhe emri i Ministrisë mbështetëse

Ministri

Nr. _____ Prot

Datë ____ . ____ . ____

LETËR MBËSHTETËSE

Në zbatim të Vendimit Nr.23, datë 26.02.2021 "*Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2020-2021, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë*" të Senatit Akademik UMT, si dhe propozimit të


(Emërtimi i institucionit ku kandidati është punësuar aktualisht)

mbështesim kërkesën e kandidatit _____
(Emër, atësi, mbiemër i kandidatit/kandidates)

Për të aplikuar me kuotat e Ministrisë _____
(Emërtimi i Ministrisë që lëshon letrën
mbështetëse)

Në programin e specializues afatgjatë në _____
(Emërtimi i programit specializues)

MINISTËR
Firma, Vula



Shtojca nr. 3

Nr.	Emër	Atësia	Mbiemër	Datëlindje	Pikët e akorduara		
					Testi i informatizuar	Nota mesatare	Pikët totale

Shtojca nr. 4

Nr.	Emër	Atësia	Mbiemër	Emër i programit specializues nga transferohet	IAL-ja nga transferohet	Viti i studimit ndjekur në vitin akademik të mëparshëm	Kreditet (ECTS) të grumbulluara nga kandidati	Emërtimi i programit të studimit specializues ku transferohet	Viti i studimit ku transferohet	Pikët e akorduara		
										Testim i informatizuar	Nota mesatare	Pikët totale
1												
2												